



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJERËZORE SJIP-A

Nr. 2162 prot.

Tiranë, më 03/12 2025

Lënda: Botim njoftimi në Buletin e Njoftimeve Publike

Agjencisë së Prokurimit Publik

Tiranë

Rektorati i Universitetit të Arteve, shpall konkursin për 1 (një) vend të lirë pune për punonjës mësimor nga kategoria “Asistent Lektor” si më poshtë:

I. FAKULTETI I ARTIT SKENIK

➤ NJËSIA BAZË REGJI, REGJI FILMI & TELEVIZIONI:

Asistent Lektor për “Programin e Studimit Regji në Lëndët Bazat e Regjisë dhe Mjeshtri Aktori” 1(një) punonjës mësimor;

I.KRITERET E PËRGJITHSHME

1. Të jetë shtetas shqiptar.
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
4. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo kundërvajtjeje penale me dashje.
5. Të mos ketë marrë ndonjë masë disiplinore për largim nga detyra.

II. KRITERE TË VECANTA:

Kandidati duhet të dorëzojë pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, këto dokumente:

1. Kërkesë, ku të jetë përcaktuar pozicioni i punës për të cilin ai konkurron;
2. Diplomë origjinale + listë notash/fotokopje e noterizuar (shkollë e lartë në profilin përkatës) e Fakultetit ku ka kryer studimet brenda ose jashtë vendit e njohur nga Ministria e Arsimit;

3. Jetëshkrim (CV) shoqëruar me dokumentacionin përkatës, që vërteton elementët e paraqitur në të (studimet; aktiviteti artistik; përvoja pedagogjike si dhe çmimet dhe vlerësimet...etj.);
4. Dëshmia mbi zotërimin e një gjuhe të huaj (bëjnë përjashtim kandidatët që kanë kryer studimet jashtë Shqipërie, sipas legjislacionit shqiptar);
5. Kanë avantazh kandidatët të cilët kanë mbi 5 (pesë) vite eksperiencë në mësimdhënie në IAL;
6. Kanë avantazh kandidatët të cilët kanë eksperiencë në mësimdhënie në lëndët “Bazat e Regjisë” ose “Mjeshtri e Aktorit”;
7. Dy referenca nga profesorë/personalitetet të fushës;
8. Të ketë eksperiencë artistike në teatrin shqiptar (regjisor ose aktor);
9. Të ketë mbi 5 (pesë) vite eksperiencë pune në një institucion artistik;
10. Vërtetim nga qendra/t e punës së mëparshme që nuk ka penalitete në drejtim të etikës profesionale dhe marrëdhënieve me kolegët;
11. Kopje të letërnjoftimit ose kartës së identitetit;
12. Çertifikatë familjare/personale;
13. Të deklarojë/dëshmojë që nuk është dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
14. Dëshmi e gjendjes mjekësore.

III. KONKURRIMI PËR PUNONJËS MËSIMORË SA MË LARTË DO TË ZHVILLOHET NË DY FAZA: (Vlerësimi maksimal 100 pikë)

1.1. Faza e parë Shqyrtimi i dosjes së kandidatit. (Vlerësimi gjithsej 40 pikë)

1.2. Faza e dytë Mësim i Hapur/Intervistë. (Vlerësimi gjithsej 60 pikë)

Intervista do të bazohet në kualifikimet e kandidatit, eksperiencia në mësimdhënie, aftësi profesionale metodike të organizimit të mësimdhënies, etj..

Dosjet e kandidatëve do të dorëzohen në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Universitetin e Arteve nga data 09 / 12 /2025 deri më datë 22 / 12 /2025.

Për datën e Konkursit kandidatët të informohen pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore çdo ditë nga ora **08.00** deri **14.00**.



Konceptoi: M. Xibraka
Ekz. 3 (tre)